



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. 93/3 prot.

Tiranë, më 20 02 .2023

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 93/1, DATË 18.01.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PA NJË VENDIM PËRFUNDIMTAR TË ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHTETASI Z. FIQIRI KULLA NË LIDHJE ME VEPRIMTARINË E ISH MAGJISTRATIT Z. E.P.”

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e z. Fiqiri Kulla me nr. 313 prot., datë 28.01.2021 ndaj veprimtarisë së ish magjistratit z. E.P., ish gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe me vendimin nr. 93/1, datë 18.01.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për përfundimin e procedurës së verifikimit pa një vendim përfundimtar të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Fiqiri Kulla në lidhje me veprimtarinë e ish magjistratit z. E.P.”, bazuar në nenin 122 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendim duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Delvinë, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Fshati “Vergo”;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen në ambientin e bashkisë përkatëse, do të hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

